

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq, anëtare, në çështjen juridike të paditësit B. K. nga ..., kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, të cilën e përfaqëson F. R., objekti i kontestit shpërblimi i dëmit material, duke vendosur përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2584/14 datë 17.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7.2.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2584/14 datë 17.10.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2584/14 datë 17.10.2018, në pikën I të dispozitivit është aprovuar ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.377/08 datë 7.5.2014, ku nën pikën I të dispozitivit, sa i përket shpërblimit të dëmit material dhe shpenzimeve të procedurës, është refuzuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit, ku ka kërkuar që e paditura të detyrohet që paditësit, në emër të dëmit material të shkaktuar si rezultat i rrënimit të objektit afarist "...", në rr. "L." ..., Podujevë, shumë prej 10.000 € si dhe të kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 200 €, të gjitha këto me kamatë që paguajnë bankat në mjetet e afatizuara mbi një vit, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së aprovuar të kërkesëpadiës prej 40.000 € si dhe nën pikën

II të dispozitivit ku është refuzuar kërkesëpadia e paditësit që i paditura t'ia paguaj paditësit shumat e kërkuara në emër të fitimit të humbur për shkak të mos ushtrimit të veprimtarisë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni dhe të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të lihet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën aprovuese të kërkesëpadiës ndërsa për pjesën refuzuese të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, në bazë të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se në bazë të kontratës lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës me nr. ..., të datës 1.2.2001, paditësit i është dhënë në shfrytëzim sipërfaqja prej 42 m² të ngastrës kadastrale ..., sipas fletës poseduese ., tokë ndërtimore për vendosjen e objektit të përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar. I padituri me vendimin nr. ..., të datës 8.5.2008 bën shpëputjen e kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës në pronësi publike me qëllim të realizimit të objekteve prioritare të miratuara në vitin 2008 gjegjësisht realizimit të projektit të ndërtimit të sheshit të qytetit. Paditësi pretendon se me rrënimin e objektit të përkohshëm në të cilën ka ushtruar veprimtarinë e tij si fotografit, është shkaktuar dëmi material për të cilin kërkon të obligohet e paditura që të paguaj dëmin. Njëherit nga shkresat e lëndës konstatohet se objekti i përkohshëm i paditësit është larguar nga paditësi dhe e paditura pa u dëmtuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, pjesërisht ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka obliguar të paditurin të paguaj dëmin si rezultat i rrënimit të objektit afarist të paditësit në shumë prej 10.000 €, ndërsa përtej shumës së kërkuar është refuzuar kërkesëpadia e paditësit si dhe kërkesa për fitimin e humbur të cilin e ka kërkuar paditësi. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se pavarësisht nga fakti se e paditura ka drejtë të shkëpusë kontratën të lidhur me paditësin për shkak se është paraqitur interesi i përgjithshëm për realizimin e planit hapësinor, mirëpo konstaton se e paditura ka vepruar në kundërshtim me kontratën lidhur me paditësin për dhënie në shfrytëzim të tokës ndërtimore për shkak se objekti i përkohshëm ka qenë

pronë e paditësit, ndërsa sa i përket veglave të punës ka refuzuar kërkesëpadinë për shkak se ato i ka larguar paditësi pa u dëmtuar fare dhe se e paditura nuk mbanë përgjegjësinë për dëmtimin e këtyre veglave.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimit ka aprovuar ankesën e të paditurit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket obligimit të paditurës që paditësi të paguaj dëmin material për rrënimin e objektit, duke vlerësuar se objekti i paditësit ka qenë i ndërtuar në kundërshtim me lejen e ndërtimit të përkohshëm dhe se paditësi nuk ka pasur të drejtë të ndërtojë objektin me material të fortë edhe pse ka qenë në dijeni që në momentin kur iu ka lejuar ndërtimi i përkohshëm i lokalit se ai mund ta shfrytëzojë pronën komunale ku ka qenë i ndërtuar lokali dhe se e paditura ka mundur të largojë lokalin, si objekt i përkohshëm, ku është paraqitur interesi publik, e në rastin konkret për ndërtimin e sheshit të qytetit në Podujevë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat procedurale dhe të drejtën materiale kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të saj.

Aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të karakterit absolut të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas mendimit të Gjykatës së Revizionit, aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj dhe se edhe Gjykata e Revizionit vlerëson se pronari i objektit të përkohshëm ka pasur të drejtën e pronësisë në objektin e përkohshëm dhe gëzon mbrojtjen gjyqësore që i takon pronarit të sendit deri në rrënimin e këtij objekti të përkohshëm. E paditura, e cila është titullari i të drejtës së pronësisë në tokën ku është vendosur objekti i përkohshëm i paditësit, ka të drejtë që të kërkojë shpërblyerjen e kontratës për shfrytëzimin e tokës dhe largimin e objektit të përkohshëm pasi që e njëjta është nevojitur për realizimin e planit hapësinor të qytetit të Podujevës, përkatësisht për ndërtimin e sheshit të qytetit si një projekt prioritar i Komunës së Podujevës. Paditësit nuk i takon e drejta e shpërblyerjes të dëmit të objektit të përkohshëm pasi që organet kompetente të Komunës së Podujevës, me rastin e largimit të këtij objekti, kanë vepruar në kuadër të autorizimeve që kanë pasur me ligj, Për të ekzistuar detyrimi për shpërblyerjen të dëmit në kuptim të nenit 136 pra.21 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve duhet të plotësohen parakushtet si janë :1.të ekzistojnë subjektet e marrëdhënies e detyrimeve dhe përgjegjësit për dëmin e shkaktuar –shkaktuesi dhe i dëmtuari;2. të ekzistoj fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi;3.të ekzistoj dëmi i

shkaktuar;4.të ekzistoj lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtuese dhe dëmit të shkaktuar dhe 5.të ekzistoj kundërligjshmëria e e veprimit ,përkatësisht mosveprimit nga është shkaktuar dëmi i dëmit. Nga kjo del se një prej elementeve është edhe veprimi i kundërligjshëm i të paditurës, që në rastin konkret nuk ekziston, pasi që e paditura ka vepruar në kuptim të dispozitave ligjore me rastin e rrënimit të objektit në fjalë.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se nuk janë vlerësuar të gjitha provat e paraqitura për arsye se gjykata e shkallës së dytë, në gjendjen e vërtetuar faktike të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpërblimin e dëmit material – rrënimin e objektit, duke konstatuar se nga ana e gjykatës së shkallës së parë gabimisht është aplikuar e drejta materiale e që gjykata e shkallës së dytë jep arsye të mjaftueshme dhe të bazuara të cilat janë të pranuar edhe nga ana e kësaj gjykate . Gjykata Supreme nuk ka vlerësuar pretendimet tjera të revizionit sa i përket vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike për arsye se në bazë të dispozitës së nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga arsyet e sipër përmendura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.5/2019 datë 7.2.2019

Kryetari i kolegjit,

Erdogan Haxhibeqiri